



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 14.9.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Sergjan Popoviq, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi dhe Mufera Shinik.

Mungoi: Salih Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të KDI –së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 2.8.2016;**
- 3. Diskutim lidhur me planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Teuta Haxhiu, propozoi që si pikë e veçantë të trajtohet çështja e fillimit të vitit shkollor, si dhe furnizimi me tekste shkollore.

Anëtarët e Komisionit, u pajtuan që lidhur me këtë propozim të diskutohet në pikën e rendit të ditës nën të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 2.8.2016

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 2.8.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor

Nait Hasani prezantoi para anëtarëve të Komisionit një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara gjatë sesionit pranveror, ku tha se janë përmbushur disa objektiva për sa i përket shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligjeve, ndërsa kanë mbetur të përmbushen edhe disa nga objektivat nga plani i punës për vitin 2016. Komisioni, gjatë sesionit pranveror ka përfunduar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Ai kërkoi nga anëtarët e Komisionit që në sesionin vjeshtor të kenë një përkushtim me të madh në përmbushjen e objektivave që dalin nga plani i punës.

Ismajl Kurteshi, lidhur me planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor, prezantoi para anëtarëve të Komisionit në formë të shkruar disa propozime që kanë të bëjnë me plotësimin e planit të punës për sesionin vjeshtor. Propozimet kanë të bëjnë me raportimin e ministrave përkatës, mbledhje me komisionin homolog të Shqipërisë, monitorimin e Ligjit për Trashëgimi Kulturor, vizita në teren, si dhe të organizohet një vizitë në Maqedoni, organizimin e konferencave, debateve etj.

Anëtarët e Komisionit, u pajtuan që këto propozime për plotësimin e planit të punës për sesionin vjeshtor, të shqyrtohen dhe analizohen dhe në mbledhjen e radhës të vendosin se cilat nga pikat e propozuara të inkorporohen në planin e punës për sesionin vjeshtor.

Shukrije Bytyqi shprehu shqetësimin e saj lidhur me vonesat rreth procedimit të projektligjit për Arsimin e Lartë.

Bekim Haxhiu, lidhur me përmbushjen e planit të punës, tha se jemi prapa për sa i përket monitorimit të ligjeve dhe në këtë aspekt do duhej një angazhim më i madh. Ai diskutoi edhe lidhur me projektligjet që mbulojnë fushën e sportit dhe në veçanti ngriti shqetësimin lidhur me tërheqjen e Projektligjit për menaxhimin e objekteve sportive nga programi legjislativ për vitin 2016.

4. Të ndryshme

Teuta Haxhiu ngriti çështjen e fillimit të vitit shkollor dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore që këtë vit shkollor MASHT ka dështuar me pajisjen me tekste shkollore për nxënësit në ciklin e ulët të arsimit parauniversitar, nga klasa I deri në klasën V. Ajo theksoi se ka

informacione se në disa DKA kanë mbetur tekste shkollore nga viti i kaluar dhe të njëjtat nuk janë shpërndarë.

Bekim Haxhiu tha se ka disa vite që e ngrit si shqetësim çështjen e peshës së çantave shkollore dhe deri me tani nuk kemi ndonjë veprim të marrë nga ministria e Arsimit për ta zgjidhur këtë problem.

Nait Hasani tha se lidhur me çështjet e ngritura në mbledhjet e radhës të ftohet ministri i Arsimit Arsim, Bajrami, për të raportuar lidhur me fillimin e vitit shkollor, si dhe ministri i Kulturës, Kujtim Shala, për të raportuar lidhur me infrastrukturën sportive dhe trashëgimin kulturore.

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me angazhimin e ekspertit Xhevdet Smakiqi, për Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Anëtarët e Komisionit kërkuar që për këtë çështje të vendosin në mbledhjen e radhës.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që mbledhjet e rregullta të mbahen ditën e hënë, me fillim nga ora 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani